



## MASTER PROFESIONAL NË “FINANCË”

### OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Ky program studimi synon të formojë ekspertë dhe specialistë cilësorë si në aspektet teorike ashtu edhe në aftësitë praktike aplikative në fushën e bankave, politikave e sistemeve fiskale, kontabilitetit e raportimit financiar si dhe auditimit të institucioneve publike dhe atij të sektorit privat. Ndër objektivat kryesorë të programit mund të përmendim pajisjen e studentëve me njohuritë themelore teorike, praktikat bashkëkohore ndërkombëtare dhe përvojën e eksperiencën shqiptare në fushën e ndërtimit, funksionimit dhe menaxhimit të bankave, bursave dhe tregjeve financiare, shoqërive të sigurimit, fondeve specifike të investimeve apo pensione, institucioneve e strukturave të specializuara në sferën e politikave fiskale, tatimore e doganore, auditimit të brendshëm e të jashtëm, menaxhimit të rreziqeve, raportimit financiar sipas standardeve ndërkombëtare, aftësisimit në vendimmarrjen efektive, lidhur me rritjen e ecurisë, përfitueshmërisë dhe efijencës së ndërmarrjeve, etj.

Nga pikëpamja e kompetencave profesionale studentet marrin aftësi të orientuara dhe specializuara në sferën e instrumenteve dhe politikave monetare, kontabilitetit bankar, marketingut bankar dhe sigurimeve, analizës së rrezikut dhe investimeve, tregjet e kapitaleve dhe bursat, standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, kontabilitetit menaxherial, analizë dhe menaxhim i buxhetit qendror dhe atyre lokale apo të organizatave e institucioneve të ndryshme, politikat dhe paketat fiskale, sistemin e taksave dhe tatimeve dhe menaxhimin e tij, funksionimin dhe specifikat e doganave, sistemet dhe funksionimi i auditit të brendshëm dhe të jashtëm në organizata publike dhe private.

### REZULTATET E TË NXËNIT

Programi i Masterit Profesional në "Financë" synon të përgatisë ekspertë dhe specialistë të kualifikuar në aspekte praktike dhe aftësi të zbatueshme në fushën e financës, duke u ofruar atyre njohuri të avancuara teorike, praktikë ndërkombëtare bashkëkohore, si dhe përvojën shqiptare në fushën e krijimit, funksionimit dhe menaxhimin e bankave, bursave dhe tregjeve financiare, kompanive të sigurimit, fondeve specifike të investimeve ose pensione, etj. Të diplomuarit e këtij programi studimi duhet të jenë të:

- demonstrojnë aftësi të të menduarit kritik dhe aftësi analitike në lidhje me detyrat financiare.
- prodhojnë rekomandime duke aplikuar mjete financiare dhe metoda analitike.
- aplikojnë metoda dhe mjete sasiore për të vlerësuar instrumentet financiare.
- vlerësojnë mjedisin financiar dhe ndikimin e politikave të qeverisë dhe institucioneve financiare.
- zhvillojnë njohuri dhe kuptim të gjerë dhe gjithëpërfshirës të fushave kryesore të bankave dhe financave.

## PROFILI: BANKA DHE TREGJE FINANCIARE

Ky profil synon të krijojë ekspertë dhe specialistë kryesisht në aftësi praktike dhe të zbatueshme në fushën e tregjeve financiare, politikave bankare dhe financave të aplikuara. Të diplomuarit në profilin Bankë dhe Tregje Financiare duhet të jenë në gjendje të:

- Analizojnë dhe vlerësojnë tregjet financiare, mënyrën se si tregtohen letrat me vlerë, fondet e përbashkëta, kompanitë e investimeve dhe sjelljen e investitorëve.
- Analizojnë dhe vlerësojnë vendimmarrjen operacionale dhe strategjike në banka dhe financa.
- Vlerësojnë strukturën e tregjeve financiare, llojet e ndryshme të letrave me vlerë dhe performancën e pjesëmarrësve në treg.

## PROFILI: KONTABILITET DHE RAPORTIM FINANCIAR

Ky profil synon të krijojë ekspertë dhe specialistë në aspekte praktike dhe aftësi të zbatueshme në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar. Të diplomuarit në profilin e Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar duhet të jenë në gjendje të:

- raportojnë dhe analizojnë raportet financiare dhe drejtojnë grupet e auditimit.
- demonstrojnë aftësi për t'u marrë me çështjet e auditimit dhe kontabilitetit dhe t'i përgjigjen zhvillimeve aktuale në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit;
- demonstrojnë njohuri për konceptet dhe teknikat e kontabilitetit të menaxhimit.

## PROFILI: AUDITIM DHE MENAXHIM RISKU

Ky profil synon të krijojë ekspertë dhe specialistë në aspektet teorike dhe aftësi praktike, të zbatueshme në fushën e auditimit dhe kontrollit të institucioneve financiare dhe korporatave. Të diplomuarit në profilin e Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut duhet të jenë të aftë të:

- raportojnë dhe analizojnë raportet financiare, drejtojnë grupet e auditimit dhe vlerësojnë/kontrollojnë rreziqet e një korporate.
- kuptojnë vlerësimin e rrezikut dhe rëndësinë e tij në funksionin e auditimit.
- demonstrojnë aftësinë për të programuar dhe dokumentuar planifikimin e një procesi auditimi duke përfshirë vlerësimin fillestar të rrezikut, llogaritjen e materialitetit dhe përgatitjen e programeve të auditimit.



## MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Punonjës e drejtues bankash, shoqëri shërbimesh apo institucione financiare në sektorë : politika monetare, mbikëqyrje bankare, operacionet monetare, sistemi pagesave, financa dhe kontabiliteti, statistikat bankare, teknologjitë e informacionit, analist dhe oficer kredie, analizë risku e menaxhim portofoli, shërbime të ndryshme bankare për klientët, sistemi leasing, marketingu bankar dhe sigurimeve, drejtori apo struktura të specializuara në studimin e tregjeve financiare kombëtare e ndërkombëtare, drejtori financiar apo kontabiliteti në institucionet publike kombëtare e lokale, sistemi i tatimeve dhe taksave, doganave, organe shtypi e media të specializuara në sferën financiare, bankave, departamente të auditimit të brendshëm, të organizatave publike kombëtare e lokale, organizatave private kombëtare e ndërkombëtare, organizatave joqeveritare, kontabilistëve profesionistë dhe shoqërive të auditimit të jashtëm e konsulencës, specialistë të auditimit financiar, etj.

**MASTER PROFESIONAL "FINANCË" 60 ECTS**

Nr.	Sem	Emri i lëndës	ECTS
-----	-----	---------------	------

**A - Lëndë Bazë/ 5-10%/6 ECTS**

1	1	Metoda kërkimi të avancuara	6
---	---	-----------------------------	---

**B - Lëndë Karakterizuese 30%-40%/ 22 ECTS**

1	1	Manaxhimi i riskut të institucioneve financiare	10
2	1	Tregjet e kapitaleve dhe institucionet financiare	6
3	2	Qeverisja e korporatave	6

22

**C - Lëndë ndërdisiplinore ose Integruese /20-30%/18 ECTS**

Profili	<b>BANKA DHE TREGJE FINANCIARE</b>		
1	1	E drejtë bankare	6
2	2	Kontabilitet bankar	6
3	2	Analizë dhe raportim financiar	6
Profili	<b>KONTABILITET &amp; RAPORTIM FINANCIAR</b>		
1	2	Auditimi financiar	6
2	1	Standartet ndërkombëtare të raportimit financiar (IFRS)	6
3	2	Kontabilitet manaxherial	6
Profili	<b>AUDITIM DHE MENAXHIM RISKU</b>		
1	1	Kontrolli i brendshëm dhe audit	6
2	2	Analizë dhe raportim financiar	6
3	2	Auditimi financiar	6

18

**D - Lëndë plotësuese 10%/ 6 ECTS**

1	2	Praktikë / internship**	6
---	---	-------------------------	---

**E - Detyrime përmbyllëse 10-20%/8 ECTS**

1	1-2	Punimi i diplomës/Provim i përgjithshëm formimi	8
---	-----	---	---

**TOTALI 60**